

UNMIK/RREG/2008/12
27 shkurt 2008

RREGULLORE NR. 2008/12
PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT 2001/36
MBI SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në përputhje me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001),

Pasi që më 22 dhjetor 2001 është shpallur Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 për shërbimin civil të Kosovës, e cila është ndryshuar,

Duke vepruar në bazë të kërkesës së Qeverisë për përfshirjen e ndryshimeve në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/36 me qëllim të zbatimit të nenit 7.2 të saj për të transformuar Këshillin e pavarur mbikëqyrës në një organ të mëvetësishëm që i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Kosovës,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshmet

Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/36 përsëri ndryshohet:

Kapitulli III ndryshohet si më poshtë:

Kapitulli III
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës

Neni 7

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës

7.1 Me anë të kësaj Rregulloreje formohet një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (më tej në tekst “Këshilli”).

7.2 Këshilli është njësi e mëvetësishme që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ia përcjell Kryeministrit të gjitha raportet e Këshillit. Të gjitha raportet e Këshillit janë dokumente publike.

7.3 Këshilli financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Do të ketë vijën e vet buxhetore në kuadër të buxhetit të Kuvendit dhe merr përkrahjen e nevojshme administrative dhe përkrahjen tjetër nga Kuvendi i Kosovës. Financimi i Këshillit i përfshin kërkesat financiare të Sekretarisë së tij. Këshilli e informon Kuvendin për propozimet buxhetore që mund të rrezikojnë aftësinë e Këshillit për zbatimin e funksioneve të tij.

7.4 Këshilli mund të merr kontribute nga donatorët. Për kontributet e donatorëve që janë në dispozicion dhe që pranohen njoftohet Kuvendi, dhe ato nuk ndikojnë në pavarësinë e Këshillit apo në të drejtën e tij në mjete financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

7.5 Niveli i pagës së kryesuesit është i barabartë me atë të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Niveli i pagës së anëtarëve të Këshillit është i barabartë me atë të gjykatësit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Neni 8

Emërimi dhe shkarkimi

8.1 Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.

8.2 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë të punës për arsye të tjera, Kryesia e Kuvendit nxjerrë shpalljen publike, ku fton konkurruesit kompetent, me integritet dhe me përkushtim ndaj krijimit të shërbimit civil politikisht të paanshëm në Kosovë të bazuar në merita dhe që pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës, që të parashtrojnë kërkesat për vendin ose vendet e lira të punës, brenda një periudhe jo më të shkurtër se njëzet e një (21) ditë.

8.3 Emërimet e propozuara që pranohen shqyrtohen nga një komision ad hoc i Kuvendit të Kosovës, i cili përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve si në vijim:

(a) Dy anëtarë emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin në të lartë të votave në zgjedhjet për Kuvend;

(b) Dy anëtarë emërohen nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e dytë më të lartë të votave në zgjedhjet për Kuvend;

(c) Një anëtar emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e tretë më të lartë të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;

(d) Një anëtar emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e katërt më të lartë të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;

(e) Një anëtar emërohet nga partia apo koalicioni që ka fituar numrin e pestë më të lartë të votave në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;

(f) Një anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit që i përkasin atyre partive, të cilat janë deklaruar se janë përfaqësuese të komunitetit joshqiptar të Kosovës dhe të komunitetit joserb të Kosovës. Metoda për emërimin e anëtarëve nga nënparagrafi (f) dhe (g) përcaktohet nga deputetët e Kuvendit që i përkasin atyre komuniteteve.

8.4 Brenda periudhës kohore prej njëzet e një (21) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni ad hoc rekomandon dy kandida të për çdo vend të lirë të punës në KPM, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për themelimin e shërbimit civil politikisht të paanshëm në Kosovë, që bazohet në merita dhe pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës.

8.5 Brenda periudhës së mëtejme kohore prej katërmëdhjetë (14) ditësh, Kuvendi i Kosovës e emëron njërin prej dy kandida tëve të rekomanduar për vend të lirë të punës, bazuar në shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

8.6 Përbërja e këshillit pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës. Në këtë drejtim, së paku tre (3) anëtarë të tij do të emërohen nga komuniteti shqiptar i Kosovës dhe së paku dy (2) anëtarë të tij nga komunitetet joshqiptare të Kosovës.

8.7 Anëtarët e Këshillit emërohen për një mandat prej pesë (5) vjetësh. Emërimi mund të ripërtërihet vetëm edhe për një mandat tjetër.

8.8 Derisa shërbejnë në Këshill, anëtarët e tij nuk kërkojnë dhe pranojnë post të zgjedhur, e as që marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike.

8.9 Anëtarët e Këshillit e zgjedhin një (1) anëtar si kryesues.

8.10 Pas rekomandimit të shumicës së anëtarëve të Këshillit apo përmes mocionit të deputetit të Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës mund ta shkarkojë nga posti secilin anëtar të Këshillit përmes votës së shumicës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës vetëm për shkak të:

- (a) mosaftësisë apo sjelljes së pahijshme të anëtarit;
- (b) mosveprimit të anëtarit në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje dhe
- (c) dënimit të anëtarit nga gjykata kompetente për ndonjë vepër penale për të cilën shqiptohet dënimi me burg.

Neni 9
Rregullorja e punës së Këshillit

Këshilli miraton rregulloren e vet të punës.

Neni 10
Funksionet e Këshillit

10.1 Këshilli:

(a) shqyrton dhe merr vendim për ankesat kundër vendimeve të organit të punësimit në pajtim me nenin 11 të kësaj Rregulloreje;

(b) vendos në pajtim me nenin 12 të kësaj Rregulloreje nëse emërimet e nëpunësve civilë në nivel të udhëheqësve të departamentit janë bërë në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje;

(c) bën vlerësimin në pajtim me nenin 13 të kësaj Rregulloreje lidhur me respektimin e organeve të punësimit përkitazi me parimet e parashtruara në nenin 2.1. të kësaj Rregulloreje dhe

(d) i paraqet raport vjetor Kuvendit të Kosovës në përputhje me nenin 14 të kësaj Rregulloreje. Kuvendi ia përcjellë Kryeministrit raportin vjetor të Këshillit.

10.2 Nëpunësit e shërbimit civil të emëruar nga KELP-i dhe ato kategori të nëpunësve civil të përjashtuar nga kompetenca e Këshillit me ndonjë dispozitë legjislative të mëvonshme janë jashtë juridiksionit të Këshillit.

Neni 11
Ankesat

11.1 Nëpunësi civil i cili është dëmtuar me një vendim të organit të punësimit, duke i shkelur parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, mund t'i ankohet Këshillit për një vendim të tillë në pajtim me dispozitat e këtij neni. Çdo ankesë e tillë duhet të shqyrtohet nga një panel prej tre (3) anëtarësh të Këshillit, të cilët në emër të Këshillit e shqyrtojnë ankesën që u është drejtuar atyre.

11.2 Rregullat dhe procedurat për ankesa sipas këtij neni caktohen nga Këshilli. Këto rregulla dhe procedura, në mes të tjerash, parashohin:

(a) që para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi i dëmtuar civil apo kandidati duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjedhur ankesën e tillë të brendshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm;

(b) që pala e dëmtuar dhe organi i punësimit të kenë mundësi t'ia paraqesin me shkrim qëndrimet e tyre Këshillit, të cilat duhet t'i vihen në dispozicion palës kundërshtuese;

(c) që në rastet e kontesteve të fakteve materiale, të dy palëve t'u jepet mundësia që së bashku të merren në pyetje para Këshillit, ku ata mund t'i paraqesin provat dhe dëshmitë gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit dhe

(ç) që për çdo ankesë që paraqitet para tij, Këshilli brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të procedurës së ankesës duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi.

11.3 Në rastet kur Këshilli bindet se përmes vendimit të kundërshtuar është shkelur parimi i parashtruar në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, ai urdhëron një mjet të përshtatshëm juridik me shkrim dhe një urdhëresë që i drejtohet sekretarit të përhershëm apo përgjegjësit kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin e urdhrat të organit të punësimit.

11.4 Në rastet kur organi i punësimit përkatës nuk i përmbahet vendimit dhe urdhrat të Këshillit, Këshilli ia paraqet rastin Kuvendit, i cili ia përcjellë raportin e Këshillit Kryeministrit të Kosovës.

11.5 Anëtar i Këshillit i cili ka marrë pjesë si anëtar i komisionit përkitazi me emërimin e një nëpunësi civil në nivel të udhëheqësit të departamentit në pajtim me nenin 12(a) të kësaj Rregulloreje, nuk mund të marrë pjesë në procedurën e ankesës ndaj vendimit të tillë.

11.6 Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 12

Shqyrtimi i emërimeve në nivel të udhëheqësve të departamenteve

Me qëllim të shqyrtimit të emërimeve të nëpunësve civilë në nivel të udhëheqësve të departamentit për të verifikuar nëse ato emërimet janë bërë në pajtim me parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, këshilli:

(a) përfaqësohet nga panelet prej tre (3) anëtarëve të Këshillit, të cilët do të marrin pjesë si vëzhgues në mbledhjet e çdo komisioni të emëruar për shqyrtimin e punësimit apo avancimit të kandidatëve për plotësimin e posteve të udhëheqësve të departamentit;

(b) pas rekomandimit të panelit përkatës që ka vepruar si vëzhgues, Këshilli vendos nëse vendimet e komisioneve të referuara në nenin 12 (a) janë marrë në pajtim me parimet e parashtruara në nenin 2.1 dhe

(c) menjëherë ta informojë me shkrim Kuvendin për vendimet e organit të punësimit që nuk janë në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 2.1. Kuvendi ia përcjellë Kryeministrit të gjitha ato komunikime të Këshillit.

Neni 13

Vlerësimi i respektimit

13.1 Me qëllim që të vlerësohet respektimi i parimeve të parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje nga ana e organit të punësimit, Këshilli për çdo vit:

(a) Shqyrton një mostër të të dhënave të punësimit që i mbajnë organet e punësimit;

(b) Vëzhgon drejtpërsëdrejti një mostër të procedurave të punësimit, të avancimit dhe të procedurave të tjera disiplinore të organit të punësimit dhe

(c) Sipas nevojës, interviston personat e punëdhënësve që janë përgjegjës për vendimet e shqyrtuara nga Këshilli.

13.2 Në rastet kur Këshilli konstaton sferat që lypset korrigjuar, ai i bën rekomandime adekuate sekretarit të përhershëm përkatës, apo udhëheqësit kryesor ekzekutiv të autoritetit përkatës të punësimit si dhe ministrit përgjegjës. Këshilli ia jep rekomandimet e veta Kuvendit të Kosovës, i cili ato ia përcjell Kryeministrit.

13.3 Këshilli i vlerëson përgjigjet e organeve të punësimit të ofruara sipas rekomandimeve të Këshillit dhe aty ku një autoritet i punësimit pa arsye nuk i zbaton rekomandimet e tilla, Këshilli ia paraqet çështjen Kuvendit, i cili ia përcjell Kryeministrit raportin e Këshillit.

13.4 Këshilli bën përpjekje që të bashkëpunojë me organet e punësimit për t'i kryer funksionet e tij në përputhje me këtë Rregullore, dhe organet e punësimit duhet të bashkëpunojnë me Këshillin. Në rastet kur organi i punësimit nuk bashkëpunon, Këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili ia përcjell Kryeministrit raportin e Këshillit.

Neni 14 Raporti vjetor

14.1 Këshilli i paraqet një raport vjetor Kuvendit të Kosovës, i cili ia përcjell raportin Kryeministrit, duke përfshirë edhe raportin për veprimtaritë e tij dhe:

(a) Një vlerësim të organeve të punësimit lidhur me respektimin e parimeve të parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje;

(b) Rekomandimet për përmirësime dhe

(c) Çështje të tjera që mund t'i kërkojë Kuvendi i Kosovës.

14.2 Raporti i Këshillit i vihet në dispozicion publikut në gjuhët zyrtare të Kosovës. Raporti botohet në Gazetën zyrtare të Kosovës

Neni 15 Kompetencat e Këshillit

15.1 Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tij në përputhje me nenin 10 të kësaj Rregulloreje Këshilli mund të:

(a) vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;

(b) ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avarcimin e nëpunësve civilë ose lidhur me shqyrtimin dhe vendimet për ankesa dhe

(c) intervistojë çdo nëpunës civil apo a lirojë të emëruarin, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

15.2 Këshilli i jep sekretarit të përhershëm apo nëpunësit kryesor ekzekutiv të organit përkatës të punësimit një njoftim të arsyeshëm për çfarëdo vizite apo kërkesë të informatave, duke cekur llojin e informatave të cilat i kërkon dhe nëpunësit civilë që kërkohen për intervistë.

Neni 16

Dispozitat kalimtare

Anëtarët e Këshillit dhe kryesuesi i tij që emërohen duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, e kryejnë detyrën deri në përfundimin e mandatit të emërimit të tyre.

Neni 17

Hyrja në fuqi

24.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Joachim Rücker

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

